

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ E HËNË 23 TETOR 2021

Të dashur qytetarë shqiptarë dhe ju bashkëqytetarë të mi, banorë të Lezhës,

Vijmë sot në këtë seancë për të folur për problemet e zonave tona. Në fakt, të gjitha seancat duhet të jenë për të diskutuar për hallet e mëdha të familjeve shqiptare dhe të kërkojmë zgjidhjen e tyre, edhe pse qeveria kërkon të na orientojë të flasim për tema abstrakte, tema me satelitë, me galaktikë, me ëndrra të bukura. E pra, unë nuk mund të flas për ëndrra të paarritshme, kur banorët e Lezhës, si në qytet, edhe në fshat çdo ditë përballen me probleme të mëdha. Në Spitalin Rajonal të Lezhës, ku marrin shërbimin shëndetësor banorët e gjithë qarkut të Lezhës, nuk ka vendparkimi. Edhe më keq është situata sot, pasi në oborrin e spitalit është ndërtuar materniteti i ri dhe as që është menduar se ku dhe si qytetarët mund dhe duhet të parkojnë automjetet e tyre. Pra, qytetarët që duan të marrin shërbimin shëndetësor në Spitalin Rajonal të Lezhës dhe gratë që marrin shërbimin pranë maternitetit të Lezhës gjenden në vështirësi, pasi nuk kanë ku të parkojnë automjetet e tyre. Tri janë zgjidhjet që u ofrohen: ose duhet të marrësh gjobë nga policia, ose duhet të lësh të sëmuret dhe gratë shtatzëna në rrugë, ose duhet të paguash për parkim. Pra, kosto financiare shtesë është edhe kjo. Le të flasim pak për gratë, meqenëse Kryeministri thotë se e ka për zemër çështjen e grave, përfaqësimin dhe punësimin e tyre. Një shqetësim i madh për nënat dhe fëmijët është se Bashkia e madhe e Lezhës ka vetëm një çerdhe për fëmijët, e cila është ndërtuar në vitet '80, kur qyteti i Lezhës kishte vetëm 3000 banorë, ndërsa sot ka mbi 35000 banorë, pra rreth 10 herë më shumë; nuk është ndërtuar asnjë çerdhe tjetër. Kjo çerdhe ka kapacitet vetëm për 120 fëmijë, ndërkohë që kërkesat janë disa herë më të mëdha, pasi në Bashkinë e Lezhës në vitin 2019 kanë lindur 1063 fëmijë dhe në vitin 2020 kanë lindur 828 fëmijë. Nënat, kryesisht ato në nevojë ekonomike, edhe po të gjejnë punë, nuk kanë mundësi të punojnë, sepse nuk kanë ku t'i lenë fëmijët e vegjël. Si do të zgjidhet ky problem? Sa para janë abuzuar për fushatë? Me aq para mund të ishin ndërtuar disa çerdhe në Bashkinë e Lezhës. E, pra, gratë janë të vlefshme dhe të privilejuara vetëm kur i shërbejnë qeverisë për dekor. Në rastet e tjera gratë nuk kanë rëndësi, nuk kanë asnjë privilegj, por përballen me vështirësitë ekonomike në çdo ditë të jetës së tyre. Fermerët e Lezhës janë një tjetër kategori e harruar. Nuk kanë një treg shitje, ku të mund t'i shesin prodhimet bujqësore dhe blegtorale. 12 muajt e vitit fermerët e Zadrimës i gjen në superstradë nga mëngjesi deri në darkë, në tentativë për të shitur prodhimet e tyre. "Prodhimi është shumë i mirë, - thotë fermeri i mollëve nga Kakarriqi, - por nuk kam ku t'i tregtoj dhe mollët po shkojnë drejt kalbjes. 200 lekë shitet 1 kg mollë me shumicë, ndërkohë që në treg të lirë mollët shiten me 1200 lekë për kilogram. Për subvencione as që bëhet fjalë. Askush nuk pyet për ta. E, pra, këta fermerë nuk kërkojnë luks, por një treg bujqësor ku të mund të shesin prodhimet e tyre dhe, pa dyshim, kërkojnë edhe mbështetje me subvencione nga shteti, përndryshe do të falimentojnë, duke kaluar nga humbja në humbje. Nuk mund të flas këtu për tema luksi, kur rruga dytësore Milot-Lezhë është e amortizuar, e shkatërruar dhe pa sinjalistikë. Kjo rrugë nuk mirëmbahet, edhe pse paguhet për mirëmbajtje dhe banorët e fshatrave Pllanë, Zejmen, Spiten, Markatomaj, Tresh dhe të gjithë përdoruesit e rrugës, çdo ditë të vitit amortizojnë automjetet e tyre. Kosto financiare shtese është edhe kjo. E, pra, asgjë nuk riparohet dhe as rregullohet, sepse paratë e buxhetit të shtetit janë abuzuar dhe vazhdojnë të abuzohen çdo ditë, janë përdorur për të blerë vota dhe për të pasuruar qeveritarët. Tani, duke ditur varfërinë, mungesën e shërbimeve, si mund të flasim

për temat luksoze të Edi Ramës, kur qindra e mijëra familje në Lezhe dhe kudo tjetër nuk kanë bukë mjaftueshëm?! Disa jetojnë me borxhe, disa punojnë punë të vogla sa për të ushqyer familjen e dikujt i vjen ndonjë lek nga fëmijët jashtë vendit, sa për të mbijetuar. A e zgjidh sateliti varfërinë ekstreme? Sipas INSTAT-it, në publikimin e majit 2019, rezulton se Lezha është qarku me papunësinë më të lartë në Shqipëri, me 19,2%, ndërsa sipas publikimit, në prill 2021 papunësia në qarkun e Lezhës u rrit me 5,3% të tjera. Kjo tregon se në qarkun e Lezhës janë 35 deri 45 mijë të papunë. Ku janë reformat e mëdha të punësimit? Ku është rritja ekonomike? Ku janë sukseset spektakolare të qeverisë? Dilni pak në qarkun e Lezhës! Bëni një sondazh! Një ndër dy të rinj kërkon të largohet nga Shqipëria për të punuar në vendet e BE-së, ndërkohë që strategu i propagandës në këtë vend ka shpikur teorinë se shqiptarët nuk duan të punojnë. E, pra, banorët e qarkut Lezhë, banorë të një qarku të varfër, me papunësi të lartë, përballen edhe me rritjen e çmimeve e këtu merr kuptim shprehja: “Çmimet si në Europë, rrogat si në Shqipëri”. Sepse, kur nuk rrit ekonominë, kur zbraz vendin nga forca punëtore, kur rrit çmimet, taksat dhe faturat e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, por, nga ana tjetër, lë në vendnumëro rrogat dhe pensionet, diskutohet 100-lekëshi e 200-lekëshi për miellin, bukën, vajin dhe gjithë shportën ushqimore, atëherë a mund të na tregoni ku është sukcesi i reformave që ju trumbetoni?! Kjo është gjendja sot. Shqipëria ka përfunduar me ekonomi të paralizuar, ku njerëzit nuk shohin rrugëdalje, nuk shohin mundësi, por vetëm krizë ekonomike, krizë shërbimesh, krizë sigurie e pasigurie për të ardhmen, ndaj dhe shqiptarët largohen çdo ditë e më shumë. Me dhimbje e them se Lezha po boshatiset dhe Shqipëria po plaket. Faleminderit!